




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm



Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016, nenit 84 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve të granteve në Komunën e Rahovecit me Nr. Prot. 2712 të datës 02.09.2019, Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm merr këtë:

V E N D I M

**Për anulimin e Thirrjes Publike për Përkrahje për Biznese me Nr. Reference 48082
të datës 21.06.2018**

1. **Anulohet** Thirrja Publike e shpallur nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm me Nr. Reference 48082 të datës 21.06.2019 për Përkrahje për Biznese në Komunën e Rahovecit.
2. Anulimi i Thirrjes Publike të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet pas rekomandimit të Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve të granteve në Komunën e Rahovecit me Nr. Prot. 2712 të datës 02.09.2019.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit që në një afat të arsyeshëm të shpallë Thirrjen Publike për Përkrahje për Biznese duke u bazuar në Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot 1427 të datës 28.04.2017.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- **Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe**
- **Arkivit.**

Artan Asllani

Drejtoria

